

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT
TË SHLP TBU
2012 - 2017**

TIRANË, DHJETOR 2011

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	3
2.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
3.	VLERAT /MISIONI	5
4.	OBJEKTIVAT	6
5.	ANALIZA SWOT.....	7
6.	DREJTIMET STRATEGJIKE	8

1. HYRJE

Shqipëria sot përballët me një realitetet, që arsimit si një e mirë publike ofrohet si nga institucionet publike ashtu dhe ato private. Liberalizimi i pranimit në arsimin e lartë, ka vënë përballë njeri – tjetrit institucionet publike dhe/ose ato private, të cilat ofrojnë të njëjtin shërbim – arsimim dhe përpiqen të bëjnë për vetë të njëjtin klient – studentin.

Në këtë realitet të arsimit të lartë, IAL private po krijojnë një fizionomi të re në arsimin e lartë. Ato po sfidojnë idenë se ekziston vetëm një lloj institucioni i arsimit të lartë, d.m.th. një institucion që ofron një gamë të plotë lëndësh dhe kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor. Në harmoni me Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë, ato po evidentojnë nevojën e diferencimit të misionit të IAL, që do t'i lejojë IAL private, që të jenë të pozicionuara dhe të realizojnë misionin dhe objektivat e tyre.

IAL private po kërkojnë që sistemi i sigurimit të cilësisë të bëjë diferencime në funksion të prioritetit – studentëve të regjistruar dhe ofrimi i një shërbimi cilësor, bazuar në standarde.

IAL private po promovojnë stafe akademike të motivuara, që nënkupton një staf të përgatitur, me një përkushtim për mësimdhënie dhe i mirëpaguar.

IAL private po ofrojnë një infrastrukture bashkëkohore, me pajisje dhe mjete moderne të gjitha në funksion të mësimdhënies. Klasa komode, biblioteka on-line, salla kompjuterësh, etj.

IAL private në Shqipëri, në kontekstin kur nevojat që ka ekonomia dhe shoqëria shqiptare për t'u bërë gjithmonë e më tepër produktive dhe konkurruese në një ekonomi dhe shoqëri të hapur globale, po synojnë të ofrojnë gjithmonë e më tepër rritjen e nivelit arsimor të të rinjve shqiptarë dhe rritjen e standardeve të edukimit dhe kërkimeve shkencore.

TBU e mbështet strategjinë e saj në 4 shtylla kryesore:

1. *autonominë akademike* – që nënkupton liritë akademike të individëve dhe atë të institucionit, që ky i fundit të mund të hartojë kurrikula novatore, përmbajtje të reja të lëndëve dhe, në kuadrin e Sigurimit të Cilësisë dhe kushtëzimeve financiare, të vendosë për hapjen apo mbylljen e degëve dhe të formimeve. Kjo gjë do të ndikojë në përcaktimin e numrit të studentëve sipas fakulteteve për TBU-së;
2. *autonominë strukturore* – që nënkupton se TBU, si një IAL, do të përcaktojë strukturat e saj të brendshme (fakultete, departamente, etj.) dhe do t'i përshtasë ato në përputhje me ndryshimet e rrethanave dhe të nevojave;

3. *autonominë administrative* – që nënkupton se TBU, si një IAL, të përcaktojë mënyrat e drejtimit në përputhje me misionin e saj –brenda kornizës së orientimeve kombëtare dhe në përputhje me praktikën më të mira;
4. *autonominë financiare* – që nënkupton se TBU, si një IAL private, krahasuar burimeve të saj financiare, do të shikojë mundësitë që të përfitojë nga grante dhe projektet të ndryshme, ku ajo do synojë të bëhet partnere.

Nëpërmjet hartimit të këtij plani të zhvillimit strategjik i cili krijohet në vazhdim të planit të biznesit mbi të cilin ka ecur TBU që nga krijimi e deri tani, synohet që të bëhet një analizë e situatës aktuale dhe të përcaktohen drejtimit strategjike kryesore mbi të cilat do të zhvillohet TBU në një afat 5 vjeçar, për periudhën 2012-2017, duke mundësuar krijimin e një universiteti me identitet të qartë dhe të diferencuar nga universitetet e tjera shqiptare.

Ky plan është përgatitur mbi bazën e një analize të gjerë të risqeve dhe sfidave që ne do të ndeshim gjatë kësaj periudhe, të aseteve që kemi në dispozicion dhe të mënyrës se si do ti shpërndajmë burimet, me qëllim që jo vetëm të përballojmë këto sfida, por mbi të gjitha për të realizuar me sukses misionin dhe objektivat tona, si edhe për të ndërtuar një institucion më të fortë dhe më konkurrues.

Plani i zhvillimit strategjik është hartuar mbi bazën e një konsultimi të gjerë me stafin akademik, stafin administrativ, studentët, etj, të cilët e kanë pasuruar atë me ide, këndvështrime dhe interesa të të gjithë aktorëve në TBU.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shkolla e Lartë Private “Tirana Business University”, lindi nga nevoja që biznesi dhe ekonomia shqiptare kanë sot për profesionistë të administrimit dhe të drejtës së biznesit, të formuar me dije dhe njohuri bashkëkohore që t’i përgjigjen kushteve të reja të zhvillimit të tregut global tepër konkurrues. Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe rritja e mirëqenies në Shqipëri janë të pamundura pa krijimin e një elite profesionistësh të përgatitur nga Universitete të dedikuara biznesit dhe ekonomisë.

Themeluesit dhe drejtuesit e SHLP TBU, falë një eksperience të gjatë në fushën e administrimit dhe të drejtës së biznesit, apo edhe në fusha që i shërbejnë zhvillimit të biznesit dhe mbrojtjes së interesave të tij, e kanë ndjerë nga afër nevojën që kanë kompanitë shqiptare për përmirësimin e cilësisë së menaxherëve, financierëve, kontabilistëve, marketierëve, juristëve të biznesit, etj, pasi janë ata që mund të rrisin eficiencën e këtyre kompanive për ti bërë ato më fitimprurëse dhe që t’i përgjigjen në mënyrë profesionale sfidave të konkurrencës globale.

SHLP TBU është krijuar nga “Tirana Business University” Sh.P.K, që u themelua në Maj 2010 nga tre ortakë, Artan Hoxha, Enea Janko dhe Gjergj Buxhuku dhe është regjistruar në Qendër Kombëtare të Regjistrimit në 1 Qershor 2010.

SHLP TBU u licencua me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 794, datë 6.10.2010. Sipas këtij vendimi, SHLP TBU organizohet në dy fakultete: Fakulteti i Administrim Biznesit dhe Fakulteti E Drejta e Biznesit.

Me urdhrin Nr. 75, datë 16.02.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është lejuar SHLP TBU për çeljen e studimeve bachelor në Fakultetin e Administrim Biznesit me profile:

- a) Menaxhim;
- b) Financë-Kontabilitet; dhe
- c) Marketing;

dhe në Fakultetin E Drejta e Biznesit.

Studimet në ciklin e parë zgjasin tre vite akademike dhe plotësohen me 180 ECTS. Duke respektuar kërkesat e Kartës së Bolonjës, këto studime synojnë të pajisin studentët me njohuritë bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike praktike nëpërmjet kryerjes së praktikave profesionale. SHLP TBU ka profil specifik në tregun e arsimit të lartë, sepse gërsheton studimin teorik me praktikën profesionale. Çdo vit të studimit studenti realizon nga 4 në 6 javë praktikë profesionale, e cila vlerësohet me notë dhe kredite.

Me urdhrin Nr. 386, datë 5.08.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, SHLP TBU është lejuar të çelë studimet master në këto programe:

- a) Master Profesional në Administrim Biznes;
- b) Master Profesional në Administrim Biznes në profilet: Kontabilitet-Financë dhe E Drejtë Biznesi;
- c) Master Profesional në Administrim Publik;
- d) Master Profesional në E Drejtë Biznesi;
- e) Master i Shkencave në Administrim Biznesi.

Programet e ciklit të dytë në Fakultetin e Administrim Biznesit për “Master i Shkencave” në Administrim Biznes zgjasin dy vite akademike me shkëputje nga puna dhe plotësohen me 120 ECTS. Programet “Master profesional” në Administrim Biznes, Administrim Biznes me Profil Financë – Kontabilitet, dhe Administrim Biznesi me profil E drejtë Biznesi, zgjasin 24 muaj pa shkëputje nga puna dhe plotësohen me 90 ECTS. Programet “Master profesional” në Administrim Publik dhe në E Drejtë Biznesi zgjasin 18 muaj me shkëputje nga puna dhe plotësohen me 60 ECTS.

Programet e ciklit të dytë synojnë thellimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve në fushën e administrimit dhe të drejtës së biznesit, me studime dhe trajnime të avancuara dhe kërkim shkencor në këto fusha.

3. VLERAT /MISIONI

Vlerat dhe besimet që ne kemi në TBU, orientojnë të gjithë punën, ambicjet dhe pasionin tonë, për arritjen e misionit dhe objektivave të vendosura.

Vlerat tona themelore janë:

- Barazia e mundësive;
- Liria akademike;
- Të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese;
- Kthimi i ideve në veprim;
- Të qënurit iniciator dhe inovator;
- Përmirësimi në mënyrë të vazhdueshëm, duke synuar përsosmërinë në vendimet dhe veprimet tona;
- Marrja përsipër e përgjegjësive;
- Zotërimi dhe aplikimi në praktikë i dijeve bashkohore;
- Puna në grup, respekti dhe vlerësimi për njëri-tjetrin;

Misioni i TBU-së është:

”Të jetë Universiteti lider në Shqipëri për edukimin e studentëve në nivel bachelor dhe master në fushat administrimit të biznesit, të së drejtës biznesit, administrimit publik, jurisprudencës, etj, duke u mbështetur në programe bashkohore studimi, zhvillimin e kërkimeve dhe studimeve shkencore, si edhe në praktikimin e dijeve të marra nga studentet në mjediset e bizneseve private, institucioneve publike dhe organizatave jo-fitimprurese shqiptare dhe të huaja”.

4. OBJEKTIVAT

- a) Ofrimi i programeve bashkëkohore të studimit të nivelit bachelor dhe master në fushat e administrimit të biznesit, të së drejtës biznesit, administrimit publik, jurisprudencës, etj, dhe angazhimi i studentëve në eksperiencë shumë inovative të edukimit, që ushqejnë vlera të rëndësishme si: krijueshmërinë, iniciativa, marrja përsipër e përgjegjësive, përgjegjshmëria, si dhe që nxitin ambicien dhe idealet e sipërmarrjes dhe lidershit për të njohur dhe shfrytëzuar të gjitha mundësitë e jashtëzakonshme që ofron bota e biznesit dhe për të arritur një karrierë të suksesshme.
- b) Ndërtimi i një stafi akademik të përkushtuar në mësimdhënie, në kërkime dhe studime shkencore, në shërbime të ndryshme, në botime dhe publikime shkencore, si edhe në angazhime publike, që do të influencojnë në mënyrë të ndjeshme, studentët, drejtuesit e kompanive të biznesit dhe politikëbërësit shqiptar, në të mirë të zhvillimit të vendit dhe rritjes së mirëqenies së shoqërisë shqiptare;
- c) Ofrimi i programeve të ndryshme afatshkurtra dhe afatmesme të trajnimit dhe kualifikimit, me specifika të veçanta në disiplina të ndryshme në fushën e administrimit të biznesit, administrimit publik, të drejtës së biznesit, jurisprudencës, etj;
- d) Ndërtimi i marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me kompanitë dhe organizatat përfaqësuese të biznesit, si edhe me institucionet publike dhe OJF shqiptare dhe të huaja, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, kryerjen e projekteve të ndryshme të kërkimit dhe zhvillimit dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme ndaj tyre;
- e) Ndërtimi i bashkëpunimeve me universitete dhe institucione të tjera mësimore, kërkimore dhe shkencore, brenda dhe jashtë vendit, për organizimin e programeve të

përbashkëta të studimeve, ndërmarrjen e projekteve të kërkim zhvillimit, organizimin e forumeve, konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme shkencore dhe publike në të mirë të komunitetit dhe shoqërisë.

- f) Konsolidimi institucional i TBU dhe realizimi i të gjitha standarteve cilësore për akreditimin institucional dhe të programeve në përputhje me kërkesat dhe standartet ligjore në fuqi;
- g) Ndërtimi i një imazhi të përsosur si shkollë e lartë për edukimin e lidërve dhe profesionistëve të biznesit, si edhe tërheqja e studentëve shumë cilësore për ndjekjen e studimeve bachelor dhe master.
- h) Rregjistrimi çdo vit i rreth 100 studentëve të rinj në programet bachelor dhe master, për të arritur një kapacitet të plotë prej 500-600 studentë që do të ndjekin studimet në TBU.

5. ANALIZA SWOT

Fuqitë

- Fokusimi vetëm në dy fakultete: Administrim Biznesi dhe e Drejtë Biznesi, do të bëjë të mundur që të ndërtojmë një identitet të qarte dhe të dallueshëm nga universitetet e tjera, të cilat janë të shpërndarë në shumë fakultete dhe programe studimi.
- Ofrimi i programeve të studimit të ndërtuara mbi bazën e kërkesave të kompanive dhe nevojave të tregut, duke siguruar jo vetëm një formim bazë, por edhe një profilizim të studentëve gjatë vitit të tretë, si edhe përfshirja e trajnimit praktik në të gjitha vitet mësimore.
- Marrëdhëniet e ngushta me organizatat e biznesit, si edhe me kompani prestigjioze brenda dhe jashtë vendit, do të bëjnë të mundur fokusimin e TBU-së, jo vetëm në trajnimin teorik dhe praktik të studentëve, por edhe përfshirjen e tyre në kërkime dhe studime të ndryshme të tregut dhe ofrimin e shërbimeve të konsulencës për këto kompani.
- Staf i akademik me profesorë nga më të përzgjedhurit në Shqipëri dhe kombinimi i tyre me lektor të cilët kanë një *background* të mirë teorik, por edhe një përvojë të gjatë praktike si menaxherë, specialistë apo drejtues të kompanive dhe institucioneve të ndryshme, do të bëjnë të mundur pajisjen e studentëve jo vetëm me dije të mira teorike, por edhe me një sens të implementimit të tyre në praktikën e përditshme të biznesit.
- Kushtet bashkëkohore të zhvillimit të procesit mësimor dhe vendndodhja në afërsi të qendrës së Tiranës është një tjetër anë e fortë e TBU-së.

Dobësitë

- TBU, është një institucion i ri dhe do të duhet pak kohë që të krijohet një imazh i qëndrueshëm dhe i dallueshëm nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri.
- Vendndodhja brenda një objekti 13 katesh dhe jo në një objekt të veçantë që do të ishte vetëm i TBU-së, krijon probleme për identifikimin e qartë të tij dhe për krijimin e një identiteti të dallueshëm viziv nga jashtë.

Mundësitë

- Imazhi i dobët që kanë krijuar deri më sot universitetet private në Shqipëri, mund të shkaktojë një devijim të numrit të maturantëve nga universitetet private ekzistuese drejt Tirana Business University.
- Hapja e Shqipërisë me vendet e BE-së, do të sjellë një rritje të investimeve të huaja, por edhe vendase dhe si pasojë do të rritet kërkesa për profesionet që lidhen me programet e studimit që ofrohen nga ana e TBU-së, dhe si pasojë edhe kërkesa për të studiuar në këto fakultete.

Kërcënimet

- Ndryshimi i politikave shtetërore për arsimin e lartë dhe i legjislacionit përkatës në fuqi, që mund të shkaktojë rritjen e kostos për universitetet private, prishjen e konkurrencës së drejtë, rritjen e numrit të kuotave të pranimit për universitetet shtetërore dhe pakësimin e numrit të studentëve të regjistruar në universitetet private, për shkak të tarifave të ulëta në universitetet shtetërore.
- Imazhi i ulët që kanë krijuar deri më sot universitetet private në Shqipëri, ka bërë që shumica e maturanëve që kanë përfunduar shkollën e mesme të besojnë më tepër tek universitetet publike për të vazhduar studimet e larta.
- Hapja e Shqipërisë me vendet e tjera dhe heqja e vizave me këto vende mund të shkaktojë një rritje të numrit të maturantëve që synojnë të studiojnë në universitetet jashtë vendit.
- Situata e vështirë ekonomike që kalon vendi aktualisht, për shkak të krizës ekonomike globale, mund të shkaktojë një ulje të numrit të studenteve që do të donin të studionin në Tirana Business University.
- Reklama negative që mund të bëhet nga universitetet konkurrencte.

6. DREJTIMET STRATEGJIKE

6.1. Organizimi Institucional

Vitet Akadematike 2010-2013

- Krijimi dhe funksionimi i strukturës organizative të TBU-së me të gjitha organet dhe autoritetet drejtuese, si Bordi Drejtues, Bordi Këshillimor Ndërkombëtar, Senati Akademik, Administratori, Rektori, Dekanët e Fakulteteve, Këshillat e Fakulteteve, Drejtuesit e Departamenteve dhe Qendrës së Kërkimeve, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Shërbimit ndaj Studentëve, Zyrën e Financës, zyrën e Marketingut, e si edhe të gjitha pozicionet e domosdoshme, për një funksionim ligjor dhe sa më profesional, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, statutin dhe rregulloren e TBU-së.

- Kompletimi i strukturave akademike, me staf të brendshëm të punësuar me kohë të plotë dhe staf të jashtëm të punësuar me kohë të pjeshme, si edhe plotësimi i strukturave menaxheriale dhe administrative, me personel sa më profesional dhe të kualifikuar.
- Plotësimi i të gjitha standardeve ligjore dhe përfundimi i procesit të akreditimit institucional dhe të gjitha programeve të studimit bachelor dhe master përpara lëshimit të diplomave të para, brenda muajit Qershor 2013.

Vitet Akademike 2013-2017

Plotësimi i strukturës organizative të TBU-së, si më poshtë:

- **Krijimi i Fakultetit të Teknologjisë dhe Inovacioneve;** Pas periudhës 3-4 vjeçare të konsolidimit të dy fakulteteve ekzistues, të administrimit të biznesit dhe të së drejtës së biznesit, TBU do të krijojë edhe Fakultetin e Teknologjisë dhe Inovacionit, i cili do të ofrojë programe studimi bazë dhe ndërdisiplinore për formimin e studentëve në nivelin bachelor dhe master në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, menaxhimit industrial, menaxhimit e inovacioneve, etj.
- **Zyra e Alumnit** (ish studentët e diplomuar në TBU), do të merret me ruajtjen e marrëdhënieve me studentët e diplomuar në TBU, me qëllim mbështetjen e tyre për punësimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre. Gjithashtu, ish studentët do jenë gjithmonë pjesë e TBU-së, për promovimin e vlerave tona më të mira, për të ndihmuar studentët e rinj në rolin e konsulentëve apo trajnuesve të tyre, për të lobuar dhe ndihmuar për donacione dhe mbështetje financiare për realizimin e projekteve të ndryshme në fushën e kërkimeve shkencore, aktivitete profesionale, kulturore, sportive, etj.
- **Zyra e Projekteve dhe Bashkëpunimit Institucional,** do të merret me zgjerimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, për krijimin dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimit në nivelin bachelor dhe master, për shkëmbimin e studentëve dhe stafeve akademike, për realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e kërkimeve shkencore, për organizimin e përbashkët të konferencave shkencore dhe aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu kjo zyrë do të merret me rritjen e bashkëpunimit edhe me kompani dhe organizata të ndryshme të biznesit brenda dhe jashtë vendit, me institucionet publike dhe organizata të ndryshme joqeveritare, etj. Punonjësit e kësaj zyre do të merren me identifikimin e të gjitha mundësive brenda dhe jashtë vendit për donacione dhe mbështetje financiare, si edhe me hartimin dhe koordinimin e projekteve të ndryshme për konsolidimin e aktivitetit të TBU-së.
- Plotësimi i të gjitha standardeve të cilësisë për tu akredituar nga një prej institucioneve ndërkombëtare të akreditimit si FIBAA ose EQUIS brenda vitit 2015.
- Organizimi i programeve të përbashkëta me universitetet të huaja në gjuhën angleze dhe tërheqja dhe pranimi për të ndjekur studimet në TBU, i studentëve të huaj nga vendet e rajonit, por edhe me gjerë do ta shndërrojë TBU një universitet ndërkombëtar brenda vitit 2016.

6.2. Mësimdhënia dhe Mësimnxënia

- Shqipëria në shekullin XXI, si kudo në Evropë, do të ketë nevojë për njerëz që kanë shprehuri fleksibël dhe të adaptueshme të menduarit, të analizës, krijimtarisë dhe zgjidhjes së problemeve, si në ekonomi, ashtu edhe më gjerë për shoqërinë. TBU gjykon se sigurimi i këtyre shprehive është ndryshimi më i rëndësishëm që i nevojitet në tërësi sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri.
- Cilësia e lartë, përmirësimi i vazhdueshëm dhe përsosmëria do të udhëheqin të gjithë veprimtarinë e TBU-së, në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë 3 viteve të para akademike, ne do të jemi të fokusuar dhe të përkushtuar për të siguruar një mjedis mësimdhënie ku të mësohet sipas standardeve më të larta evropiane.
- Studentët janë në qendër të veprimtarisë sonë dhe ne jemi të angazhuar për të plotësuar të gjitha nevojat e tyre për të siguruar një proces sa më të shkëlqyer për mësimdhënien dhe mësimnxënien e tyre, me qëllim edukimin e tyre me aftësi të spikatura akademike, profesionale dhe njerëzore, si edhe kultivimin tek ata të vlerave më të mira si: të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, të qenit iniciator, sipërmarrës, inovator dhe të përgjegjshëm, etj. Në këtë mënyrë studentët tanë do të jenë tepër konkurrues për tregun shqiptar dhe global të punës dhe do të arrijnë një karrierë të suksesshme.
- Ne do të tërheqim për të studiuar në TBU studentë shumë cilësorë, duke siguruar jo vetëm kushte model për mësimdhënien dhe të mësuarit nga ana e tyre, por duke i siguruar edhe lehtësira financiare të konsiderueshme, si bursa studimi 100%, 75% dhe 50%, si edhe bonuse të tjera.
- TBU do të rishikojë kriteret e pranimit të studentëve në vitin e parë të studimeve bachelor dhe master, pas konsolidimit të imazhit të tij të mirë, duke vendosur kriteret më të forta pranimi për studentët, si nota mesatare, kalimi i një testi pranimi, etj.
- Profesionalizmi, përgjegjshmëria dhe integriteti i të gjithë stafit tonë akademik të brendshëm dhe të jashtëm janë një garanci e fortë për ndërtimin e një kulture të brendshme në TBU, që stimulon dhe vlerëson punën e palodhur dhe ambiciet për sukses të studentëve tanë. Shumica e pedagogëve të TBU-së, kanë jo vetëm një karrierë të pasur akademike, por zotërojnë njëkohësisht edhe një eksperiencë të madhe praktike si drejtues apo profesionistë të kompanive, institucioneve apo organizatave të ndryshme, çka i bën ata të dallueshëm nga shumica e pedagogëve tradicional shqiptar që zotërojnë vetëm një formim teorik.
- Gjatë 3 viteve të para akademike puna jonë do të jetë e fokusuar për ofrimin e të gjitha programeve të studimit bachelor dhe master për të cilat TBU është licencuar dhe ka marrë lejen e hapjes së tyre nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
- Ne besojmë se kurrikulat e ofruara nga TBU, mundësojnë dhënien e dijeve më bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit dhe të së drejtës së biznesit, por ne do

të ndjekim procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të këtyre kurrikulave, sipas zhvillimeve më të fundit të këtyre shkencave dhe nevojave që ka ekonomia dhe biznesi.

- Pas tre viteve të para akademike, TBU do të hartojë dhe ofrojë kurse afatshkurtra studimi në fusha shumë specifike, por duke dhënë kreditet përkatëse për këto kurse, të cilat mund të organizohen si kurse me module në vazhdim për të plotësuar kreditet për marrjen e një diplome bachelor apo master profesional.
- Ne do të zbatojmë një proces mësimdhënie që bazohet te interaktiviteti i studentëve, sipas metodologjisë “mësojmë duke vepruar”, ku studentëve jo vetëm u transmetohen njohuritë teorike nga ana e pedagogut, por i jepet mundësia edhe për t’i zbatuar praktikisht njohuritë dhe dijet e marra gjatë orëve të mësimit në auditor, por edhe gjatë praktikave mësimore të detyrueshme që janë përfshirë në programet tona të studimit që prej vitit të parë akademik deri në vitin e fundit.
- Metodologjia e mësimdhënies dhe testimi i treguesve të mësimnxënies së studentëve, është tepër e larmishme dhe përfshin, leksionet, seminarët, ushtrimet praktike, esetë, projektet, etj, të cilat mundësojnë jo vetëm edukimin e studentëve me njohuritë dhe dijet teorike më bashkëkohore në shkencat përkatëse, por edhe edukimin e tyre me aftësitë më të mira, akademike, profesionale dhe njerëzore.
- TBU synon që, krahas metodave aktuale të mësimdhënies, nevojitet që ato të përditësohet me të rejtat më të fundit dhe brenda Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, që të përputhet me kuadrin e përgjithshëm të HEAL-it. TBU është vënë në lëvizje për të adoptuar një përfaqje modulare dhe sistem të transferimit të krediteve për kurset e studimit, që është ndër prioritetet e Procesit të Bolonjës. TBU ka kuptuar se sistemi i modularizimit dhe i transferimit të krediteve nuk bëhet për qëllime administrative, por për të përfituar studentët. Ky sistem synon zgjerimin e shanseve për studentët, duke u siguruar atyre zgjedhje reale dhe mundësi transferimi, veçanërisht në kuadër të programeve evropiane, që e lejojnë mobilitetin e studentit.
- Infrastruktura dhe teknologjia e mësimdhënies që do të mundësohet për studentët dhe stafin akademik do të jetë më bashkëkohorja e mundshme, duke përfshirë, klasat dhe sallat me hapësira optimale dhe të pajisura me tavolina komode, projektor, ajër të kondicionuar, ndriçim perfekt, qasje interneti, smart board, laborator kompjuterik, bibliotekë, etj.

6.3. Kërkimet Shkencore

- Ndërsa gjatë tre viteve të para akademike ne do të jemi të fokusuar kryesisht te sigurimi i standardeve më të larta për mësimdhënien dhe të mësuarit, gjate periudhës 2013-2017, do të përkushtohemi njëkohësisht në realizimin e një programi të gjerë kërkimesh shkencore.
- Kërkimet shkencore do të përqendrohen kryesisht në fushat e ekonomisë, biznesit dhe mjedisit ligjor dhe rregullator të ekonomisë dhe biznesit dhe do të fokusohemi në tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me konkurrencën, investimet, menaxhimin, marketingun,

shitjet, financat, tregun financiar, tregun e kapitaleve, politikat fiskale, politikat monetare, politikat ekonomike, etj.

- Mungesa e kërkimeve dhe studimeve shkencore ka qenë një ndër faktorët kryesorë që ekonomia dhe biznesi shqiptar është zhvilluar në mënyrë kaotike dhe instiktive pas vitit 1990 e deri tani. Kjo ka bërë që burimet materiale, financiare dhe njerëzore të vendit të keqpërdoren dhe shfrytëzohen pa efektivitet.
- Ne do ta shndërrojmë TBU në një qendër aktive të kërkimit shkencor, që do të shërbejë si një prej “*software*”-ve më të rëndësishëm të orientimit të investimeve publike dhe private, të rritjes së konkurrencës së kompanive dhe ekonomisë shqiptare në tërësi, si edhe për ndërtimin e politikave sa më efektive.
- Përveç pedagogëve të brendshëm, ne do të tërheqim në TBU dhe do të angazhojmë në projektet e kërkimit shkencor pedagogë dhe profesionistë të njohur sipas fushave përkatëse, si edhe do të përfshijmë në këtë proces edhe disa prej studentëve tanë më të mirë të cilët do të zhvillojnë në TBU aftësitë e tyre kërkimore shkencore dhe do të ndërtojnë një karrierë të sigurt akademike.
- Në kurrikulat e TBU, si në nivelin bachelor ashtu edhe nivelin master, janë përfshirë lëndë që transmetojnë te studentët njohuritë më bashkëkohore për metodologjitë dhe teknikat e realizimit të kërkimeve dhe analizave shkencore, si edhe edukojnë aftësitë për të bërë kërkime, analiza, studime dhe publikime shkencore.
- TBU synon t’i përgjigjet në të ardhmen ndryshimeve të shoqërisë shqiptare dhe prirjeve evropiane. TBU gjykon se për të pasur një mësimdhënie cilësore dhe me informacion të pasur, personeli akademik duhet të angazhohet në një punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike që t’i lejojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse. Kjo veprimtari duhet dalluar nga “kërkimi shkencor” fundamental i mirëfilltë, i cili nënkupton përftim rezultatesh origjinale.
Në një vend të vogël si Shqipëria, duke pasur parasysh edhe stadin aktual të zhvillimit, kërkimi shkencor fundamental mund të përballohet ose të ndërmerret nga një numër relativisht i kufizuar punonjësish akademikë. Për këtë kategori punonjësish, TBU synon që në të ardhmen të mundësojë financimin e kërkimit shkencor që do të realizohet përmes një procesi konkurrues.
- TBU do të krijojë një mjedis shumë tërheqës për kërkimet, ku stafi ynë do të ketë kohën e nevojshme dhe do të mbështetet me infrastrukturën dhe buxhetet financiare të domosdoshme për të realizuar të gjitha projektet e rëndësishme të kërkimeve shkencore që do të planifikohen.
- TBU do të zhvillojë marrëdhënie të qëndrueshme me kompanitë e njohura të biznesit, institucionet publike dhe shoqërinë civile, duke gjeneruar donacione dhe të ardhura edhe nga kompanitë e biznesit, fondet publike dhe programet e institucioneve ndërkombëtare që mbështesin kërkimet shkencore.

- TBU do të jetë një partner shumë serioz dhe produktivë në fushën e kërkimeve të përbashkëta me universitetet dhe institucionet e tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

6.4. Partneritetet

- Gjatë tre viteve të para akademike 2010-2013, TBU do të fokusohet në ndërtimin e partneriteteve me disa nga organizatat më të rëndësishme të biznesit brenda vendit, si Konfindustria, Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri, Shoqata Austriake e Biznesit në Shqipëri.
- Do të krijohen partneritete bashkëpunimi me disa nga kompanitë më të njohura në vend që operojnë në industrinë prodhuese, sektorin financiar dhe bankar, sektorin e shërbimeve të marketingut, shërbimeve ligjore, shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit, etj.
- Gjithashtu do të krijohen partneritete bashkëpunimi me disa nga institucionet publike shqiptare të cilat merren me hartimin dhe zbatimin e politikave, makroekonomike, fiskale, monetare, si edhe me çështje që lidhen me veprimtarinë e biznesit dhe funksionim e ekonomisë në tërësi, si: Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Qendra Kombëtare e Licencimit, Autoriteti i Konkurrencës, etj.
- Nëpërmjet krijimit të partneriteteve të mësipërme do të mundësohet realizimi i veprimtarive me interes të ndërsjelle, si: kryerja e praktikave profesionale të studentëve pranë kompanive, realizimi i projekteve të përbashkëta në fushën e kërkim-zhvillimit, promovimi i dyanshëm i aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve që realizohen prej palëve, identifikimi dhe rekrutimi i studentëve më të mirë për t'u punësuar nga kompanitë, angazhimi i drejtuesve dhe specialistëve të kompanive dhe organizatave si lektorë të ftuar, furnizimi i studentëve dhe stafit akademik me të dhëna nga kompanitë për realizimin e projekteve studimore, diplomave, etj.
- TBU do të krijojë brenda vitit 2013 një “rrjet partnerësh ekzekutivë”, me biznesmenë, menaxherë, financierë, marketierë dhe juristë të mirënjohur, të cilët do të shërbejnë si udhëheqës të karrierës për studentët më të talentuar të TBU-së, si gjatë viteve të studimeve ashtu edhe më pas, për t'i mbështetur ata për t'u bërë sa më konkurrues dhe për të ndërtuar një karrierë të suksesshme.
- Nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e biznesit dhe institucionet publike, TBU do të mundësojë organizimin e vazhdueshëm të tryezave të diskutimit dhe debatit, forumeve dhe simpoziumeve të ndryshme, etj, për të trajtuar tema dhe problematika të ndryshme që lidhen me zhvillimin e ekonomisë, biznesit, ligjshmërisë etj.
- Pas një periudhe 2-3 vjeçare që do të shërbejë për konsolidimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe të imazhit të TBU-së, do të synohet krijimi i partneriteteve me universitete dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për të zgjeruar aktivitetin me programe të përbashkëta studimi bachelor dhe master, për realizimin e

projekteve të përbashkëta për kërkime të ndryshme shkencore, për rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik, për organizimin e konferencave shkencore, etj.

6.5. Angazhimi ndaj Grupeve të Interesit, Komunitetit dhe Publikut

- Organizimi i konkursit kombëtar “Sipërmarrësit e së Nesërme”, me pjesëmarrjen e maturantëve të shkollave të mesme nga i gjithë vendi, për të identifikuar, stimuluar dhe mbështetur të rinjtë e talentuar që duan të zhvillojnë karrierë akademike dhe profesionale në fushën e administrimit dhe sipërmarrjes.
- Organizimi i aktiviteteve për këshillimin e karrierës për maturantët e shkollave të mesme të vendit, duke mundësuar takimet dhe diskutimet ndërmjet tyre dhe profesionistëve nga kompanitë e punësimit dhe të këshillimit të karrierës, drejtuesit e kompanive apo profesionistë nga fushat e biznesit dhe jurisprudencës, me qëllim njohjen e maturantëve me mundësitë që ofron tregu i punës në Shqipëri, aftësitë dhe dijet e kërkuara për të qenë i suksesshëm në tregun e punës apo në sipërmarrje, etj.
- Organizimi i seminareve të trajnimit për mësuesit e ekonomisë të shkollave të mesme, si edhe për drejtuesit e shkollave të mesme, me qëllim që të krijojmë një mjedis sa më të favorshëm dhe profesional për mësimdhënien në lëndët e ekonomisë, sipërmarrjes dhe financave personale që janë në programet e shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale, si edhe për të siguruar një drejtim sa më profesional të shkollave të mesme.
- Organizimi çdo vit i “Javës së sipërmarrjes shqiptare” në kuadrin e javës së sipërmarrjes evropiane, me qëllim promovimin e sipërmarrjeve të suksesshme shqiptare, organizimin e debateve për rëndësinë dhe vlerat që ka sipërmarrja për punësimin e të rinjve dhe zhvillimin social-ekonomik të vendit.
- Ngritja dhe funksionimi i një qendre /klinike ligjore, në ofrimin e një asistence të specializuar juridike, veçanërisht në fushën e biznesit, për shoqëritë tregtare, për biznesin dhe për çdo të interesuar, i cili kërkon të hapë një biznes ose cenohet në ushtrimin e aktivitetit të tij në fushën e biznesit.
- Organizimi i diskutimeve, debateve, forumeve dhe konferencave shkencore të ndryshme, për çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik, biznesin, legjislacionin, etj.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore, si ekspozita arti, forume diskutimi, etj, për mbështetjen dhe promovimin e krijimtarisë dhe trashëgimisë kulturore shqiptare.
- Pjesëmarrja e drejtuesve dhe stafit akademik në debate, intervista mediatike, diskutime të ndryshme publike, etj, për të dhënë mendimet për çështje që i përkasin ekonomisë, biznesit, fushës ligjore, etj.
- Ofrimi i shërbimeve të ndryshme të konsulencës, për kompanitë dhe organizatat e biznesit, institucionet publike, organizatat jo-fitimprurëse.

- Organizimi i fushatave të ndryshme promocionale në shërbim të mbështetjes së praktikave të mira të biznesit, mbështetjes së sipërmarrjes së të rinjve shqiptarë, mbështetjes së SME-ve, etj.

6.6. Botimet dhe Publikimet

- Publikimi i revistës “Tirana Business & Economy” në një periodik, çdo 3 muaj, brenda vitit 2013, me synim e miratimit të saj nga MASH, si një revistë shkencore, me qëllim që të publikohen artikuj shkencorë të stafit akademik të TBU, të akademikëve të universiteteve dhe institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit. Kjo revistë do të jetë e fokusuar në çështje të ndryshme nga fusha e biznesit dhe ekonomisë kombëtare dhe globale.
- Botimi dhe publikimi i i 2-3 teksteve mësimore, të cilat përbëjnë literaturën bazë për programet mësimore të studimit në bachelor dhe master nga stafi akademik i brendshëm dhe i jashtëm i TBU-së, për çdo vit akademik, duke filluar nga viti 2013 e më pas.
- Publikimi i një gazete *on-line* dhe “*hard copy*” nga ana e studentëve të TBU-së, në vitin 2013, ku do të pasqyrohen aktivitetet studentore, do të publikohen artikuj të ndryshëm nga ana e studentëve që lidhen me fushat e tyre të studimit, etj.
- Publikimi *on-line* në *website-in* e TBU-së dhe në mediat sociale të saj si në faqet e facebook, linked in, etj, e të gjithë artikujve, intervistave të stafit drejtues, stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve të TBU-së.

6.7. Jeta Studentore

- Krijimi i mundësive për zhvillimin e një jete të pasur studentore në shërbim të formimit profesional, por edhe të rritjes personale, të forcimit dhe konsolidimit të vlerave më të mira njerëzore të studentët tanë, si respekti reciprok, fryma e ekipit dhe e ndihmës ndaj njëri-tjetrit, do të jetë ndër prioritetet më të rëndësishme të stafit drejtues të TBU-së.
- Do të organizohen aktivitete të shumta artistike, kulturore, sportive, etj, të cilat do t’ju mundësojnë studentëve të TBU-së që të evidentojnë aftësitë dhe talentin e tyre.
- Do të krijohet “Klubi i Sipërmarrësve të Rinj Shqiptar”, ku do të marrin pjesë studentë të TBU, por mund të ftohen edhe studentë të universiteteve të tjera që janë të pasionuar ndaj sipërmarrjes. Ky klub do organizojë aktivitete të ndryshme në fushën e sipërmarrjes dhe do të shndërrohet në një qendër të krijimit të ideve të reja, të hartimit të projekteve të ndryshme studentore sipërmarrjeve, të mbështetjes dhe promovimit të vlerave më të mira që krijon sipërmarrja, etj.

- TBU do të mbështesë krijimin e ekipeve të ndryshme sportive sipas interesave të studentëve, për t'u përfaqësuar nëpër kompeticione të ndryshme studentore brenda vendit.
- TBU do të mbështesë zhvillimin e iniciativave të përbashkëta midis studentëve tanë dhe studentëve të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit. Do të përpiqemi që çdo vit të organizojmë udhëtime dhe vizita në 2-3 universitete të huaja në vende me tradita si në Austri, Gjermani, Itali, etj
- TBU do të mbështesë pjesëmarrjen e studentëve apo ekipe të studentëve në konkurse dhe gara të ndryshme që ata do të dëshirojnë të marrin pjesë, si edhe do të stimulojë angazhimin e tyre për të përfaqësuar TBU në konferenca, diskutime, debate të ndryshme publike dhe mediatike.

6.8. Menaxhimi dhe Marketingu

- TBU do të synojë që të ndërtojë një menaxhim sa më profesional të burimeve njerëzore, burimeve financiare dhe marketingut për të realizuar të gjitha objektivat dhe synimet e vendosura në programet afat shkurtër të veprimit dhe planin strategjik të zhvillimit.
- Stili i menaxhimi do të jetë ai nëpërmjet vendosjes së objektivave, ku secili pjesëtar i ekipit do të jetë i motivuar për të realizuar detyrat individuale, të përshkruara me detaje në “përshkrimin e punës”, në kontratat individuale të punës, por edhe në rregulloren e universitetit.
- Mënyra e rekrutimit të stafit akademik dhe administrativ do të jetë ajo e bazuar në meritat dhe mbi bazën e konkurrimit të hapur, me qëllim që të afrojmë pranë TBU, profesionistë nga më të zotët në fushat përkatëse.
- Marketingu i TBU-së, do të jetë i larmishëm dhe do të synojë krijimin e një identiteti shumë të dallueshëm dhe të diferencuar nga universitetet e tjera, si edhe krijimin e një imazhi të një universiteti elitari në fushën e biznesit, ku cilësia dhe përsosmëria janë vlera dominuese e studentëve, stafit akademik, stafit administrativ etj.
- Marketingu do të bazohet kryesisht në komunikimin e drejtpërdrejtë me nxënësit e shkollave të mesme, me mësuesit, prindërit, me studentët apo ata që janë të interesuar për vazhdimin e studimeve në TBU, nëpërmjet takimeve dhe prezantimeve të drejtpërdrejta, organizimin e aktiviteteve të ndryshme, etj.
- Marketingu do të përfshijë edhe përdorimin e mediave radio-televizive, ku do të transmetohen spote publicitare të cilat do të ndërtohen mbi bazën e vlerave që ofron dhe krijon TBU. Gjithashtu do të përdoren edhe mediat e shkruara, billboardet, fletëpalosjet, broshurat, etj.
- Një vend shumë të rëndësishëm në promovimin e TBU-së do të zërë edhe përdorimi i mediave sociale, si website i TBU-së, faqja facebook, linked in, etj, ku do të pasqyrohen

gjërësisht informacionet dhe veprimtaritë që realizon TBU, si edhe do të publikohen të gjitha rregulloret, raportet e cilësisë, kriteret e pranimit dhe të studimit, kriteret e punësimit, etj.

6.9. Qëndrueshmëria Financiare

- Financimi i veprimtarisë së TBU-së në vitet e para do të realizohet nëpërmjet kontributit financiar të ortakëve themelues, si edhe nëpërmjet pagesës së tarifave të studimit nga ana e studentëve.
- Pas konsolidimit institucional dhe imazhit të TBU-së, do të krijohen mundësi financimi nga donatorë vendas dhe të huaj nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të projekteve të ndryshme nga zyra e projekteve, si për organizimin e programeve të reja të studimit, kërkime dhe studime shkencore, si edhe nga realizimi i shërbimeve të ndryshme si: kërkime tregu, konsulenca për bizneset dhe institucionet publike dhe jo qeveritare, etj.
- Do të shikohet edhe mundësia e shtimit të numrit të ortakëve duke afruar si aksionar kompani të fuqishme biznesi, të cilat përveç kontributit financiar mund të ofrojnë edhe mundësi të shumta për realizimin e praktikave të studentëve, apo për promovimin e TBU-së.
- TBU do të realizojë një menaxhim shumë të kujdesshëm financiar me qëllim sigurimin dhe rritjen e vazhdueshme të burimeve të financimit, për përmbushjen me sukses të të gjitha veprimtarive mësimore, kërkimore, botuese, etj, si edhe arritjen e objektivave dhe synimeve të vendosura në këtë strategji.

6.10. Infrastruktura dhe Teknologjia

- TBU ka investuar për të krijuar një infrastrukturë dhe teknologji shumë bashkëkohore për zhvillimin e një procesi mësimor dhe studimor sa më optimal, duke krijuar kushte të përshtatshme për studentët dhe stafin akademik dhe administrativ, si salla leksionesh, klasa seminaresh, salla për diskutime, laboratorë kompjuterik, bibliotekë e pasur me libra dhe botime bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, ambiente sanitare, ambiente çlodhëse, me hapësira dhe ndriçim shumë optimal, të pajisura me pajisjet, mjetet dhe teknologjinë më bashkëkohore të mësimdhënies dhe të studimit, si tavolina, dhe karrige shumë komode, projektor, ajër të kondicionuar, akses interneti, smart board, etj.
- TBU do të bëjë në mënyrë të vazhdueshme përmirësime dhe plotësime të infrastrukturës dhe teknologjive të nevojshme, si futja e bibliotekës on line, shtimi i titujve të rinj të teksteve, revistave ekonomike, juridike, kompletimi i sa më shumë klasave dhe sallave me smart board, apo krijimi i ambienteve të tjera për plotësimin e nevojave të studentëve apo stafit akademik, etj.

- Ambientet e TBU-së janë të vendosura brenda qytetit të Tiranës në një zonë shumë të aksesueshme nëpërmjet transportit urban, si edhe të kompletuar me ambiente të reja për banimin e studentëve që jetojnë me qira, me ambiente për ngrënie dhe çlodhje, etj.